-fitimet e viteve ushtrimore të mëparshme për një shumë të përgjithshme prej 703.504 Euro (shtatëqind e tre mijë e pesëqind e katër), për një total, pra, prej 1.960.575 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë); për sa i përket shumës që mbetet prej 6.625 Euro (gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzetepesë) që duhet për të arritur shumën e plotë prej 3.000.000 Euro (tre milionë), ajo duhet të derdhet, pa prim (mbivlerë), nga ortakët (të cilët, nga kontaktet jozyrtare të mëparshme janë treguar të gatshëm për këtë gjë në këtë mbledhje të asamblesë);

Në lidhje me këtë, në cilësinë e Administratorit të Vetëm – sikurse konfirmon Kryetari i Bordit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, - siguron se vendimi i rritjes së kapitalit të shoqërisë mund të zbatohet duke qenë se të gjitha kontributet e detyrueshme të mëparshme janë kryer në mënyrë të plotë.

Asambleja, pas dëgjimit të raportit të Kryetarit, pas një diskutimi të shkurtër njëzëri vendosi për të rritur kapitalin e shoqërisë nga 1.032.800,00 Euro (një milionë e tridhjetë e dy mijë e tetëqind presje zero zero) në 3.000.000,00 Euro (tre milionë presje zero zero) duke bërë mbulimin e kapitalit të rritjes në mënyrat e ilustruara nga Kryetari i Asamblesë;


Për këtë qëllim, ortakët kërkojnë dhe u pranohet një ndërprerje e shkurtër e punimeve të asamblesë në mënyrë që të procedohet me derdhjen në arkën e shoqërisë të kuotës së kapitalit në pjesët përkatëse; si rrjedhojë, ortaku Luigi Fortunato derdh shumën prej 6.558,75 Euro (gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë mijë presje shtatëdhjetepesë) dhe ortaku Fortunato S. r L. Derdh shumën prej 66,25 Euro (gjashtëdhjetë e gjashtë presje njëzetepesë), që të dy në format e parashikuara nga normativa në fuqi në fushën në fjalë, sikurse vërtetojnë edhe Kryetari i Asamblesë dhe Kryetari i Bordit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;

Duke marrë në konsideratë propozimin për shndërrimin e shoqërisë dërgohet çdo vendim për ndryshimin statutor vijues për t'u trajtuar në pikën e tretë të rendit të ditës.

Në pikën e dytë të rendit të ditës, Kryetari përcakton konsideratat në dritën e të cilave u vlerësua e përshtatshme për të propozuar "rregullime" të lehta të qëllimit të shoqërisë, pa ndikuar minimalisht në konsistencën e saj, por me qëllimin e vetëm për ta bërë atë më pajtues ndaj atyre që janë aktivitetet e realizuara realisht nga shoqëria; pasi u procedua me ilustrimin e ndryshimeve të propozuara, i lexon asamblesë së ortakë atë që, nëse vetë propozimi pranohet, do të jetë teksti i ri i i nenit të statutit të shoqërisë që ka të bëjë me objektin; pas kësaj fton asamblenë që të marrë vendim dhe ajo në përfundim të një diskutimi shumë të shkurtër, vendosi unanimisht të pranojë propozimin në termat e saktë në të cilat ishte formuluar dhe siç rezulton nga teksti i sapo lexuar nga Kryetari;

në çështjen e tretë të rendit të ditës, Kryetari ilustron dhe në këtë rast, të gjitha konsideratat në dritën e të cilave duket e përshtatshme të vazhdohet me shndërrimin e shoqërisë nga forma e saj aktuale në atë të shoqërisë aksionare, duke sqaruar gjithashtu se, rrjedhimisht, pjesëmarrja e ortakëve, natyrisht, që do të përbëhej nga aksione, me një vlerë nominale prej njëqind Euro secila, të cilat nuk përfaqësohen nga tituj aksionarë dhe që do t'u atribuohen ortakëve në përputhje të saktë me kuotat e tyre pjesëmarrëse aktuale; pas kësaj, vazhdon me leximin e asaj se çfarë, nëse mbledhja

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin origjinal në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA







e ortakëve vendos shndërrimin e shoqërisë, propozohet si tekst i ri i statutit të shoqërisë, duke theksuar, ndër të tjera, se është çmuar e përshtatshme që të afrohet nga data 31 dhjetor 2050 në datën 30 qershor të të njëjtit vit, afati i kohëzgjatjes së kompanisë për ta njëzuar atë me datën e mbylljes së viteve financiare të shoqërisë (30 qershor të çdo viti).

Pas mbarimit të raportit të tij dhe marrjes së mendimit të favorshëm të Bordit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, shprehur nga Kryetari i tij, fton asamblenë që të vendosë dhe kjo, në fakt, vendos:

- të shndërrojë shoqërinë nga forma e saj aktuale në atë të një shoqërie aksionare, me emrin "GEMANCO SPA", me kohëzgjatje deri më 30 qershor 2050 dhe kapitali i së cilës prej 3.000.000 Euro, do të përbëhet nga 30.000 (tridhjetë mijë) aksione, me një vlerë nominale prej 100,00 Euro (njëqind pikë zero zero) secili, jo të përfaqësuar nga tituj aksionesh dhe që do t'iu caktohen aksionarëve në përpjesëtim me aksionet e mbajtura nga secili prej tyre deri më tani, e përkatësisht: aksionarit Luigi Fortunato për 29.700 (njëzet e nëntë mijë e shtatëqind) aksione, për një total prej 2.970.000 euro (dy milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë), barabartë me nëntëdhjetë e nëntë për njëqind të kapitalit aksionar;

Fortunato s.r.l.-së një numër prej 300 (treqind) aksionesh, për një total prej 30.000 Euro (tridhjetë mijë), barabartë me një për qind të kapitalit të shoqërisë;

- të miratojë statutin e ri të shoqërisë në tekstin e sapo lexuar dhe ilustruar nga Kryetari,  
- në dritën e tekstit të ri të statutit të shoqërisë të sapo miratuar që në nenin 17 parashikon që shoqëria të administrohet nga një Administrator i Vetëm ose nga një Këshill Administrimi (i përbërë nga një numër anëtarësh të përcaktuar nga asambleja që kryen emërimin), të cilët do të mbajnë detyrën për jo më shumë se tre vite ushtrimore, Asambleja, për më tepër, vendos që shoqëria të vazhdojë të administrohet nga një Administrator i vetëm, duke konfirmuar në detyrë ortakun Z. Luigi FORTUNATO dhe duke caktuar që mandati i tij të jetë tre vite financiare (d.m.th. deri në asamblenë që do të aprovojë bilancin e vitit financiar për vitin 2013 (dy mijë e trembëdhjetë);

- të konfirmojë në detyrën e anëtarëve të Bordit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar edhe ata gjithashtu për tre vitet e ardhshme financiare (domethënë deri në asamblenë që do të aprovojë bilancin për vitin financiar që do të mbyllet më 30 qershor 2013) zotërinjtë:

Francesco Paolo Noviello, me funksionin e Kryetarit;

Francesco Panza dhe Pasquale Schena, me funksionin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të përhershëm;

Francesco Loboano dhe Giuseppina Basta, me funksionin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar zëvendësues;

duke konfirmuar masën e shpërblimit të tyre në mënyrat e përcaktuara tashmë dhe duke përcaktuar se kontrolli ligjor i llogarive është kryer nga Bordi i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, anëtarët e të cilit janë të gjithë të jenë Ekspertë Kontabël, të regjistruar rregullisht në regjistrin përkatës, siç tregohet më lart;

të konfirmojë që vitet financiare do të vazhdojnë të mbyllën më 30 qershor të çdo viti dhe për këtë arsye viti i ardhshëm financiar do të mbyllet më 30 qershor 2011.

Asambleja autorizon të gjitha zyrat kompetente që të shënojnë kryerjen e shndërrimit të llojit të shoqërisë dhe ndryshimin pasues të emërimit të shoqërisë në "GEMANCO S.P.A." dhe si rrjedhojë, të gjitha pozicionet e regjistruara deri më tani në emër të "GEMANCO S.R.L." të kalojnë me emrin e "GEMANCO S.P.A." dhe një gjë e tillë pas paraqitjes së thjeshtë të një kopjeje të këtij procesverballi, me përjashtimin nga çdo përgjegjësi në këtë drejtim.

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin origjinal në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA

Përkthyesit e Autorizuar  
ROVENA SHKA  
Traduttore Giurato

*Noviello, Pasquale*



Meqenëse nuk ka asgjë tjetër për të vendosur dhe askush nuk kërkon fjalën, Kryetari, në orën dhjetë e dyzet minuta, e deklaroi mbledhjen të mbyllur pasi më dorëzoi tekstin e plotë të "Statutit" të modifikuar, në hartimin e tij të përditësuar, siç parashikohet nga neni 2436 i Kodit Civil, ky Statut i bashkëlidhet këtij procesverbal nën germën "A".

Unë Noteri

Ia lexova këtë procesverbal, me aneksin, në mbledhje, të paraqiturit që deklaroi se e miratoi. Është shtypur nga një person i besuar prej meje, dhe është plotësuar prej meje në rreth tetë faqe të këtyre dy fletëve dhe nënshkruhet në orën dhjetë e dyzetetë minuta. Nënshkruar nga Luigi Fortunato – Cesare Cerasi, Noter.

Aneksi "A" me nr. koleksioni 17861.

## STATUTI KREU I

### THEMELIMI – EMËRTIMI – SELIA- ADRESA E NJOFTIMIT-KOHËZGJATJA-OBJEKTI

#### NENI 1

1 – Është themeluar një shoqëri aksionare me emërtimin "GEMANCO S.p.a".

#### NENI 2

1 – Shoqëria e ka selinë në Modugno, në adresën që rezulton nga regjistrimi specifik i bërë në Zyrën kompetente të Regjistrimit të Shoqërive në zbatim të nenit 111 ter të dispozitave zbatuese të Kodit Civil.

2 – Shoqëria ka aftësinë, në format e ligjit, të krijojë, transferojë dhe mbyllë degë, zyra dhe seli dytësore në vende të tjera në territorin e Republikës dhe jashtë saj.

#### NENI 3

Adresa e njoftimit e ortakëve, administratorëve dhe drejtorëve, për marrëdhëniet e tyre me shoqërinë, është ajo që tregohet në librat e shoqërisë.

#### NENI 4


Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar për më 30 qershor 2050 dhe mund të zgjatet.

#### NENI 5

Shoqëria ka si objekt:

- Prodhimin industrial, tregtimin e brendshëm dhe ndërkombëtar si dhe përpunimin e plehrave kimike për llogari të vetën dhe të të tretëve;
- ruajtjen dhe përpunimin, për llogari të vetën dhe të të tretëve, të ullinjve për vaj, drithëra dhe bishtajore, zgjedhjen e farave dhe tregtimin e tyre;
- kultivimin, blerjen, shitjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore;
- realizimin dhe menaxhimin e impianteve për prodhimin e energjisë alternative;
- shitblerjen dhe ndërtimin e kabanoneve, edhe për qëllime që nuk janë rreptësisht të lidhura me ato të shoqërisë;
- marrjen dhe dhënien me qira të vinçave dhe pajisjeve ngritëse dhe lëvizëse në përgjithësi;

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin original në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA





- ushtrimin e sipërmarrjes për operacionet portuale, siç parashikohet nga neni 111 i Kodit i Lundrimit;

-aktivitetin e ndërtimit dhe çmontimit të anijeve dhe shërbimeve të tjera, sipas nenit 68 të Kodit të Lundrimit

2. Shoqëria mund të marrë dhe të japë agjenci, komisione, përfaqësime, me ose pa depozitim, dhe mandate, të blejë, të përdorë dhe transferojë patenta, know-how dhe vepra të tjera të inteligjencës njerëzore, të kryejë kërkime tregut dhe përpunim të dhënash për llogari të vetën ose të të tretëve, të japë dhe të marrë licenca shfrytëzimi tregtar.

3. Ajo, në përputhje me legjislacionin që rregullon çështjet specifike dhe, për rrjedhojë, pas marrjes së autorizimeve, lejeve të ushtrimit të aktivitetit dhe udhëzimeve të kërkuara, dhe në përputhje me të gjitha kushtet e tjera të parashikuara, mund të kryejë çdo operacion industrial tregtar, financiar, të luajtshëm dhe të paluajtshëm që konsiderohen nga organi administrativ si i dobishëm ose i përshtatshëm dhe të marrë, direkt ose indirekt, interesa ose kuota pjesëmarrëse, përfshirë ato aksionare, në shoqëri apo sipërmarrje që kanë një objekt të ngjashëm ose të ndryshëm nga i saji.

Për qëllimin e ngushtë të arritjes së qëllimit të shoqërisë, shoqëria mund të lëshojë garanci, fidejusione dhe garanci pasurore edhe në favor të të tretëve.

## NENI 6

### KAPITALI DHE AKSIONET

Kapitali i shoqërisë është 3.000.000 € (tre milionë), i ndarë në 30.000 (tridhjetë mijë) aksione me një vlerë nominale 100 (njëqind) Euro secili.

Në rast të rritjes së kapitalit, kontributet mund të bëhen në para ose pasuri të tjera që i atribuohen pasurive me zbatimin e parimit që lejon mundësinë të dhënies së aksioneve në mënyrë jo proporcionale kontributit vetë.

Aksionet nuk përfaqësohen nga letrat me vlerë të kapitalit.

Secili ortak ka të drejtën e një votë për secilin aksion.

Secili ortak ka të drejtën të marrë nga shoqëria një certifikatë që vërteton cilësinë e tij si ortak dhe shumën e pjesës së kapitalit në pronësi të tij sipas të dhënave që rezultojnë në librin e ortakëve.

## NENI 7

### Transferimi i aksioneve

Transferimi i aksioneve ka efekt kundrejt shoqërisë që nga momenti i regjistrimit në librin e ortakëve.

Aksionet mund të transferohen lirshëm me akt midis të gjallëve dhe me trashëgimi për shkak të vdekjes.

Për transferimin me akt midis të gjallëve, aksionet janë të transferueshme në kushtet e treguara më poshtë.

Ortaku që ka ndërmend të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, aksionet e tij duhet të njoftojë organin administrativ me letër rekomande njoftim marrjeje.

Ky komunikim duhet të përmbajë të dhënat personale të transferuesit, kushtet e transferimit, veçanërisht çmimin, metodat dhe afatet e pagesës. Organi Administrativ, brenda dhjetë ditëve nga marrja e komunikimit të lartpërmendur, duhet t'u komunikojë të gjithë ortakëve përmbajtjen e plotë dhe fjalë për fjalë.

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin original në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA



*[Handwritten signature]*



Ortakët që synojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes duhet t'ia komunikojnë shoqërisë, me shkrim ose me letër rekomande me njoftim marrjeje, qëllimin e tyre brenda tridhjetë ditëve nga marrja e ofertës. Organi administrativ informon menjëherë ortakun transferues për aderimet e marra.

Ortaku që ushtron të drejtën e parablerjes ka të drejtë të blejë aksionet ose një pjesë të tyre me të njëjtin çmim, pro quota, dhe me kushtet e treguara nga transferuesi në letrën rekomande që përmban ofertën e transferimit. Në rast të ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga më shumë se një ortak aksionet e ofruara u përkasin ortakëve të interesuar në përpjesëtim me pjesëmarrjen e zotëruar nga secili prej tyre.

Nëse ndonjë nga ata që kanë të drejtën e parablerjes nuk mund ose nuk dëshiron ta ushtrojë atë, e drejta që i përket atij rritet automatikisht dhe proporcionalisht në favor të atyre ortakëve që, anasjelltas, synojnë ta shfrytëzojnë atë dhe nuk kanë hequr dorë në mënyrë të shprehur dhe paraprakisht nga akti i ushtrimit të së drejtës së parablerjes që u përket atyre.

E drejta e parablerjes u takon ortakëve edhe kur synohet të transferohet pronësia e pabarrësuar e aksioneve.

Në hipotezën e themelimit të uzufuktit ortakët e tjerë kanë të drejtë të preferohen sipas mënyrës dhe kushteve të mësipërme.

Në rast të vdekjes së një prej ortakëve, trashëgimtarët mund të vazhdojnë të marrin pjesë në shoqëri ose të kërkojnë rimbursimin e aksioneve brenda gjashtë muajve nga vdekja, në zbatim të nenit 2437 –quater të Kodit Civil. Vlera e aksioneve përcaktohet nga Administratorët, pasi është dëgjuar mendimi i Bordit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, duke mbajtur parasysh përbërjen pasurore të shoqërisë dhe perspektivat e saj të të ardhurave.

Mosrespektimi i klauzolave të parablerjes të përshkruara më lart e bën të pavlefshëm transferimin e aksioneve kundrejt shoqërisë; Prandaj, blerësi nuk ka të drejtë të jetë i regjistruar në librin e ortakëve dhe as që të ushtrojë asnjë prej të drejtave që lidhen me aksionet objekt transferimi.

## NENI 8

### Instrumentet financiare

Shoqëria mund të emetojë, me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme, instrumente financiare të pajisur me të drejta pronësore ose edhe me të drejta administrative, duke përjashtuar votimin në asamblenë e përgjithshme të aksionarëve dhe duke përjashtuar votën në lidhje me emërimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe Bordit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Asambleja e jashtëzakonshme rregullon modalitetet dhe kushtet e emetimit, të drejtat që japin instrumentet financiare, sanksionet për mos kryerjen e shërbimeve dhe ligjin e mundshëm të qarkullimit.

## NENI 9

### Obligacionet

Shoqëria mund të emetojë obligacione.

Organi Administrativ mund të vendosë emetimin e obligacioneve për një shumë totale që nuk e tejkalon dyfishin e kapitalit të shoqërisë të paguar dhe ekzistues, të rezervës ligjore dhe rezervave të disponueshme sipas bilancit të fundit të miratuar, dhe vendimi përkatës duhet të depozitohet dhe regjistrohet me metodat e parashikuara në nenin 2436 të Kodit Civil.

Zbatohet disiplina e mbetur e Kodit Civil.

## NENI 10

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin original në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA



*Rovena Vyshka*



## Mbledhja e Asamblesë

Asambleja është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme.

Asambleja mund të mbledhet edhe jashtë selisë së shoqërisë mjaft që të jetë në Itali.

Asambleja thirret nga Organi Administrativ, kur ai e gjykon të përshtatshme, ose me kërkesën e Bordit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ose me kërkesën e aq ortakëve që përfaqësojnë të paktën një të dhjetën e kapitalit të shoqërisë; në rastin e fundit në kërkesë që duhen treguar edhe çështjet që do të trajtohen.

Asambleja duhet të thirret nga Organi Administrativ të paktën një herë në vit, brenda 120 ditëve nga përfundimi i vitit financiar, ose brenda 180 ditëve, kur e kërkojnë kërkesa të veçanta që lidhen me strukturën dhe objektin e shoqërisë. Në këto raste, administratorët përcaktojnë në raportin e parashikuar nga neni 2428 i kodi civil arsyet e zgjatjes së afatit.

Thirrja bëhet me njoftim që u komunikohet ortakëve, me mjetet që garantojnë vërtetimin e kryerjes së marrjes (telefaks, postë elektronike, letër rekomande ose mjete të tjera të ngjashme), të paktën 8 (tetë) ditë para mbledhjes, në adresën që rezultojnë në librin e ortakëve.

Njoftimi i thirrjes së asamblesë duhet të përmbajë përcaktimin e ditës, orës dhe vendit të mbledhjes si dhe listën e çështjeve të vëna në rend të ditës.

Në njoftim mund të parashikohet një datë e një thirrjeje të dytë të Asamblesë. Në këtë rast, asambleja e thirrjes së dytë mund të mbahet brenda tridhjetë ditësh nga data e caktuar për thirrjen e parë; ajo nuk mund të mbahet të njëjtën ditë me asamblenë e thirrjes së mëparshme.

Edhe në mungesë të një thirrjeje zyrtare, Asambleja çmohet e mbledhur rregullisht dhe vendos sipas paragrafëve 4 dhe 5 të nenit 2366 kod civil.

## NENI 11

Kompetencat e Asamblesë së zakonshme dhe të jashtëzakonshme të ortakëve.

Asambleja e zakonshme, në përputhje me nenin 2364 të Kodit Civil:

- miraton bilancin e vitit ushtrimor;
- emëron dhe shkarkon Administratorët, Drejtorët dhe Kryetarin e Bordit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
- përcakton shpërblimin që pi përket administratorëve dhe drejtorëve;
- vendos për përgjegjësinë e Administratorëve dhe Drejtorëve;
- vendos për shitjen ose qiranë e shoqërisë ose degëve të ndërmarrjes;
- vendos për objektet e tjera që i atribuohen me ligj kompetencës së asamblesë;
- miraton rregulloren e mundshme të punimeve të asamblesë.

Asambleja e jashtëzakonshme, në bazë të nenit 2365, paragrafi 1, i Kodit Civil:

- vendos për ndryshimet e statutit;
- vendos për emërimin për zëvendësimin dhe fuqitë e likuiduesve;
- diskuton për çdo çështje tjetër që ligji ia rezervon shprehimisht kompetencës së saj.


## NENI 12

Kuorumet konstituive dhe vendimmarrëse

Asambleja e zakonshme si në thirrjen e parë ashtu edhe në atë të dytë konstituohet rregullisht me praninë e aq ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë dhe merr vendime me shumicë absolute.

Asambleja e jashtëzakonshme, në thirrjen e parë dhe të dytë konstituohet në mënyrë të vlefshme dhe merr vendime në mënyrë të vlefshme me praninë dhe votimin e favorshëm të aq ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të shoqërisë.

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin original në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA





### NENI 13

#### E drejta e pjesëmarrjes dhe e përfaqësimit në mbledhje

Mund të marrin pjesë në asamble aksionarët që në atë datë rezultojnë të regjistruar në librin e ortakëve.

Secili ortak mund të përfaqësohet në asamble vetëm nga ortakët e tjerë, duke përjashtuar anëtarët e organeve administrative dhe të kontrollit dhe punonjësit e kompanisë. Megjithatë, ortaku i vetëm mund të përfaqësohet në asamble edhe nga palë të treta që nuk kanë lidhje me strukturën e shoqërisë. Prokura duhet të lëshohet me shkrim dhe duhet të tregojë emrin e përfaqësuesit. Ajo është gjithnjë e revokueshme, pavarësisht nga çdo marrëveshje e kundërt, dhe mbetet e administruar në aktet e shoqërisë.

### NENI 14

#### Kryesia

Asambleja kryesohet nga Administratori i vetëm ose nga Kryetari i Këshillit të Administrimit ose, në rast të mungesës ose pamundësisë së tij, nga Zëvendës Kryetari; në rast të mungesës ose pamundësisë edhe të këtij të fundit, asambleja kryesohet nga Këshilltari më i vjetër në detyrë ose, në rast emërimi të njëkohshëm, nga Këshilltari më i vjetër në moshë.

Asambleja cakton një sekretar, edhe jo ortak. Nuk nevojitet ndihma e sekretarit nëse procesverbali hartohet nga një noter.

Procesverbali duhet të hartohet pa vonesë, brenda kohës së nevojshme për ekzekutimin në kohë të detyrimeve të depozitimit dhe shpalljes, kur kërkohen, dhe duhet të nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari ose noteri, nëse kërkohet.

### NENI 15

#### Sistemet e administrimit dhe kontrollit

Shoqëria adopton sistemin tradicional të administrimit, siç kërkohet në paragrafët 2, 3 dhe 4 të Seksionit VI bis të Kreut V të Librit V të Kodit Civil (nenet nga 2380 bis deri në 2409 septies), dhe ia beson kontrollin kontabël Bordit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, duke mos u mbështetur në tregun e kapitalit të riskut dhe duke mos pasur detyrimin e përgatitjes së një bilanci të konsoliduar.

### NENI 16

#### Kompetencat dhe fuqitë e Organit Administrativ

Menaxhimi i zakonshëm dhe i jashtëzakonshëm i shoqërisë i përket ekskluzivisht Këshillit të Administrimit ose Administratorit të Vetëm, të cilat kryejnë të gjitha operacionet e nevojshme për zbatimin e objektit të shoqërisë.

I atribuohet po ashtu Këshillit të Administrimit ose Administratorit të vetëm, në përputhje me nenin 2365, paragrafi 2, të Kodit Civil Italian, kompetenca për të vendosur rreth shkrirjes në rastet e parashikuara nga neni 2505 dhe 2505 bis, për krijimin ose mbylljen e selive dytësore, në tregimin se cili prej administratorëve ka përfaqësimin e shoqërisë, për uljen e kapitalit në rast të tërheqjes së ortakut, mbi rregullimet dhe dispozitat normative të statutit, për transferimin e selisë së shoqërisë në territorin kombëtar.

### Neni 17

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin original në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA



*Rovena VYSHKA*



Përbërja dhe çështjet e Organit Administrativ  
(Administratori i vetëm ose Këshilli i Administrimit)

Shoqëria administrohet nga një administrator i vetëm ose nga një Këshill Administrimi, i përbërë nga një numër anëtarësh i përcaktuar nga Asambleja që kryen emërimin. Kompetenca, në zgjedhjen e llojit të organit, me një administrator apo me këshill, identifikimin e numrit të saktë të administratorëve, emërimin, shpërblimin vjetor si dhe rimbursimin e shpenzimeve të bëra për përmbushjen e mandatit dhe, eventualisht, dëmshpërblimin e likuidimit, i përkasin asamblesë së zakonshme.

Organi Administrativ mbetet në detyrë për periudhën e përcaktuar në aktin e emërimit dhe, në çdo rast, jo më vonë se tre vite financiare dhe skadon në datën e asamblesë së thirrur për të aprovuar bilancin në lidhje me vitin e fundit financiar të detyrës. Komponentët e tij mund të rizgjidhen. Ndërprerja, zëvendësimi, rënia dhe revokimi i administratorëve rregullohen me ligj.

Nëse - për shkak të dorëheqjes ose ndonjë shkakut tjetër - mungon shumica e administratorëve, i gjithë Këshilli konsiderohet i rënë dhe duhet të thirret asambleja për emërimet e reja sa më shpejt që të jetë e mundur.

NENI 18

Kryetari

Këshilli i Administrimit, në mbledhjen e parë pas emërimit të tij, zgjedh nga radhët e anëtarëve të tij Kryetarin dhe eventualisht nënkryetarin nëse asambleja nuk e ka bërë një gjë të tillë. Kryetari Këshillit të Administrimit thërret këshillin, cakton rendin e ditës, koordinon punën e dhe sigurohet që tu jepen të gjithë këshilltarëve informacionet adekuate mbi temat e rendit të ditës. Këshilli emëron herë pas here një sekretar edhe jashtë anëtarëve të tij.

NENI 19

Organet e deleguara

Këshilli i Administrimit mund t'ia delegojë një pjesë të kompetencave të tij, brenda limiteve të përcaktuara në nenin 2381 të kodit civil, një ose më shumë anëtarëve, duke përcaktuar fuqitë dhe shpërblimin përkatës.

Organi Administrativ gjithashtu mund të emërojë drejtorë të përgjithshëm duke përcaktuar fuqitë dhe shpërblimet.

Kryetari i Këshillit të Administrimit, me autorizim të këshillit, mund të emërojë përfaqësues të posaçëm dhe persona të autorizuar për kryerjen e akteve individuale ose kategorive të akteve, duke përcaktuar shpërblimet.

Nuk mund të delegohen kompetencat e përmendura në nenin 2381, paragrafi 4, të kodit civil.

Këshilli gjithmonë mund t'u japë direktiva organeve të deleguara dhe të kryejë vetë operacione që përfshihen në autorizim. Ndër të tjera, mbi bazën e informacioneve të marra, mund të vlerësojë përshtatshmërinë e strukturës organizative, administrative dhe kontabël të kompanisë. Ai gjithashtu mund të ekzaminojë planet strategjike, industriale, financiare, tregtare dhe të marketingut të shoqërisë, si dhe të vlerësojë në bazë të raportit të organeve të deleguara ecurinë e përgjithshme të menaxhimit.

Organet e deleguara kujdesen që struktura organizative, administrative dhe kontabël, të përshtatet natyrën dhe dimensionet e shoqërisë.

Administratorëve u kërkohet të veprojnë në mënyrë të informuar; çdo administrator mund t'u kërkojë organeve të deleguara që në këshill të jepen informacione që kanë të bëjnë me menaxhimin e shoqërisë.

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin original në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA



*Rovena VYSHKA*



## NENI 20

### Vendimet e Këshillit të Administrimit

Këshilli mbledhet në vendin e treguar në njoftimin e thirrjes, në selinë e shoqërisë ose diku tjetër, me kusht që të jetë në Itali, kur bëhet një kërkesë me shkrim nga të paktën (1/3) një e treta e anëtarëve të saj. Thirrja bëhet të paktën 3 dite të plota para mbledhjes, apo edhe 1 ditë më parë në rast urgjence, me një njoftim me shkrim që do të kundërfirmoset për marrje me dorë ose me telegram, faks ose e-mail ose mjete të ngjashme. Në mungesë të këtyre formaliteteve, Këshilli vendos në mënyrë të vlefshme me praninë e të gjithë Administratorëve dhe Drejtorëve të përhershëm në detyrë. Mbledhjet e Këshillit kryesohen nga Kryetari ose Zëvendës Kryetari, nëse është emëruar, ose nga administratori më i vjetër në detyrë. Për vlefshmërinë e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit dhe vendimeve përkatëse, kërkohet prania efektive e shumicës së anëtarëve të tij në detyrë.

Vendimet miratohen me shumicë absolute të votave të të pranishmëve: në rast barazie, vota e kryetarit mbizotëron; sidoqoftë, në rast se këshilli përbëhet nga vetëm dy anëtarë, në rast të barazisë vendimi konsiderohet i rrëzuar. Vendimet duhet të përbëhen nga procesverbale të nënshkruara nga kryetari i mbledhjes dhe sekretari.

Votimi nuk mund të jepet me anë të përfaqësimit.

## NENI 21

### Përfaqësimi dhe Fuqitë

Përfaqësimi ligjor i shoqërisë i përket Kryetarit të Këshillit të Administrimit ose, në rast mungese ose pengese, Zëvendëskryetarit nëse është i emëruar, si dhe subjekteve të deleguara brenda kufijve të prokurës.

Administratori i vetëm ka përfaqësimin ligjor të shoqërisë para palëve të treta dhe në gjykatë dhe gëzon fuqitë për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë. Anëtarët e këshillit të Administrimit dhe Administratori i vetëm kanë të drejtë të rimbursohen për shpenzimet e bëra për arsye të detyrës së tyre. Asambleja mund t'u caktojë atyre një shpërblim vjetor dhe t'u njohë të drejtën për të marrë një dëmshpërblim për ndërprejrien e marrëdhënieve të punës, që do të vendoset përmes rezervave vjetore ose me anë të një police sigurimi të posaçme.

## NENI 22

Veprimi i shoqërisë i përgjegjësisë së ushtruar nga ortakët.

Veprimi i shoqërisë i përgjegjësisë, në zbatim të nenit 2393 bis të Kodit Civil, mund të ushtrohet nga ortakët që përfaqësojnë një të tretën e kapitalit të shoqërisë.


## NENI 23

### Bordi i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Kontrolli i administratës i atribuohet Bordit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, në përputhje me nenin 2397 dhe në vijim të kodit civil, si dhe kontrolli i kontabilitetit në bazë të nenit 2409 bis paragrafi i fundit i të njëjtit kod civil, duke ushtruar funksionet e përmendura në nenin 2409 ter dhe me përgjegjësitë në bazë të nenit 2409 sexies, gjithnjë të kodit civil.

Bordit të Auditorëve përbëhet nga tre anëtarë të përhershëm dhe dy zëvendës. I gjithë Bordi duhet të përbëhet nga ekspertë kontabël të regjistruar në regjistrin e vendosur pranë Ministrisë së Drejtësisë. Bordi duhet të mbledhet çdo 90 ditë.

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin original në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA







Shpërblimi i ekspertëve kontabël të autorizuar përcaktohet nga asambleja në momentin e emërimit; në mungesë, përcaktohet në bazë të tarifës profesionale të Kontabilistëve të Miratuar.

Ekspertët Kontabël të Autorizuar të Përhershëm dhe Zëvendësues mbeten në detyrë për tre vite financiare dhe iu mbaron afati në datën e Asamblesë së thirrur për të aprovuar bilancin në lidhje me vitin e fundit financiar të detyrës së tyre.

Ato mund të rizgjidhen nga Asambleja.

#### NENI 24

##### Bilanci dhe fitimet

Viti financiar përfundon në 30 qershor të çdo viti.

Fitimet neto që rezultojnë nga blinaci, pas zbritjes së të paktën 5% (pesë përqind) që do të shkojnë për rezervën ligjore, derisa kjo të arrijë një të pestën e kapitalit të shoqërisë, shpërndahen midis ortakëve në masë përpjestimore me pjesëmarrjen aksionare të zotëruar nga selici prej tyre, përveçse ku asambleja nuk merr vendime për rezerva të mëtejshme për fondet e rezervës së jashtëzakonshme.

Shoqëria mund të marrë nga ortakët pagesa dhe financime, me ose pa detyrim rimbursimi, në përputhje me normativat në fuqi, duke iu referuar veçanërisht atyre që rregullojnë mbledhjen e kursimit në publik.

Financimet duhet të konsiderohen pa interesa, përveç nëse vendoset ndryshe nga asambleja, dhe mund të bëhen edhe në mënyrë jo proporcionale me kuotën e pjesëmarrjes në kapital nga secili ortak.

#### NENI 25

##### Prishja dhe likuidimi

Prishja dhe likuidimi rregullohen me normat ligjore.

#### NENI 26

##### Klauzola për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet e treguara më poshtë duhet t'i shtrohen për gjykim një kolegji të arbitrazhit:

- mosmarrëveshjet midis ortakëve, ose, ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë, të cilat kanë si objekt të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet shoqërore, me përjashtim të atyre në të cilat ligji parashikon ndërhyrjen e detyrueshme të prokurorit;

- mosmarrëveshjet e ngritura nga administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar, ose ato të ngritura kundër tyre, të cilat kanë si objekt të tyre të drejta në dispozicion në lidhje me marrëdhënien shoqërore.

Kolegji i arbitrazhit është i përbërë nga 3 arbitra, të gjithë të caktuar nga Kryetari i Gjykatës së vendit ku është selia e shoqërisë. Arbitrat e emëruar në këtë mënyrë caktojnë Kryetarin e kolegjit të arbitrazhit.


Selia e kolegjit të arbitrazhit është vendosur në adresën e Kryetarit të kolegjit të arbitrazhit. Kolegji i arbitrazhit vendos rregullisht, sipas ligjit, brenda termave ligjorë.

Kostot e arbitrazhit i bart pala humbëse, përveç rasteve kur kolegji i arbitrazhit vendos ndryshe. Vendimet dhe përcaktimet e kolegjit të arbitrazhit janë detyruese për palët.

#### NENI 27

##### Dispozita përfundimtare

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin original në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA



*Rovena Vyshka*

Për çdo gjë që nuk rregullohet shprehimisht me këtë statut, zbatohen normat e përfshira në kodin civil, të ndryshuar me dekretin legjislativ nr. 6/2003 dhe modifikimet vijuese.

Nënshkruar: Luigi FORTUNATO - Cesare CERASI Noter

Kopje e përbërë nga katër fletë, të cilat unë, noteri i nënshkruar, vërtetoj se janë në përputhje me origjinalin dhe i lëshoj për përdorimet e lejuara me ligj.  
Bari më 12 tetor 2011

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin original në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA



Unë i nënshkruari Prof. Marco TATARANO, Noter në Bari, i regjistruar në Dhomën e Noterëve të Rrethit të Barit, vërtetoj se kopje, e cila përbëhet nga shtatë fletë, është në përputhje me dokumentin e paraqitur në fotokopje në format elektronik të "GEMANCO SPA", me seli në Modugno (Bari) në Via delle Petunie, nr.1, Kapitali Themeltar Euro 3.000.000,00 i derdhur tërësisht, kodi fiskal dhe numri i regjistrimit pranë Zyrës së Regjistrimit të Shoqërive të Barit 00170390744, NUIS 03583300722, regjistruar me nr. 266140 REA pranë CCIAA të Barit (Libri), me pullë takse të rregullt, të legalizuar nga noteri Giuseppina Raguso e Gravina in Puglia më datë 12 shkurt 2018, Repertor nr. 1527 dhe se pjesët e hequra nuk e ndryshojnë dhe as e tjetërsojnë përmbajtjen e ekstraktit.

Lëshohet në letër të thjeshtë me kërkesë të shoqërisë për përdorimet e lejuara e ligj dhe i dorëzohet shoqërisë duke e njohur me pasojat civile dhe penale që hasen në rast paraqitjeje të dokumenteve të rreme ose që përmbajnë të dhëna të pavërteta.

Bari, Via Principe Amedeo nr. 66, më 29 (njëzetënëntë) prill 2020 (dymijë e njëzet).

Firma, vula

<b>APOSTILLE</b> <i>(Konventa e Hagës e 5 tetorit 1961)</i>	
1. Shteti:	<b>ITALI</b> Ky Akt Publik
2. Është firmosur nga	<b>MARCO TATARANO</b>
3. Në cilësinë e	<b>NOTERIT</b>
4. Mban vulën/pullën	<b>MARCO TATARANO DI GIORDANO</b> <b>NOTER NE BARI</b> Vërtetuar
5. Në	<b>BARI</b>
6. Më	<b>30 Prill 2020</b>
7. Nga	<b>Prefektura e Republikës</b>
8. Me numër	<b>417/2020</b>
9. Vula	
	<b>10. FIRMA</b> <b>Prokurori i Republikës</b> <b>Alessio Cocioli</b> <i>(Firma), Vula</i>

Ky përkthim është kryer në përputhje me tekstin original në gjuhën italiane nga Përkthyesi i Autorizuar: Rovena VYSHKA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ELIDA TAKE**



**DATE 13/05/2020  
NR REP 359**

V2020053770010553617



**VËRTETIM PËRKTHIMI**

Sot, më datë 13/05/2020, para meje Notere ELIDA TAKE, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 5, RR. TISH DAIJA, GODINA NR. 9, NJESIA 1, HYRJA 1, u paraqit personalisht:

**PËRKTHYES:**

Rovena Vyshka, atësia Edmond, amësia Efeli, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane, Tirane dhe banues në TIRANE, me adresë 1017 Njesia bashkiake nr. 8 Rruga Shinasi Dishnica Pall.56 Shk.1 Ap.7, lindur më 13/09/1978, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032589599 dhe nr. personal H85913095H.

Përkthyesja është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, ie cili/a më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur "Procesverbali i asamblese, Republika Italiane", nga gjuha Italisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë";" në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroi se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER  
ELIDA TAKE**

*Elida H. Take*

